



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 15
Prishtinë, më 28.2.2018, në orën 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Aida Dërguti, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjeni Thaçi-Dragusha dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Sergjan Mitrovic.

Pjesëmarrës nga radha e deputetëve ishte: Sami Kurteshi.

Nga stafi i Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, sipas vendimit të mbledhjes plenare të datës 28 shkurt 2018

Vjosa Osmani-Sadriu, theksoi se takimi është ftuar bazuar në vendimin e mbledhjes plenare dhe ka të bëjë me nenin 3, të Projektligjit nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, i cili është propozuar për shqyrtim në komision, me përmbajtjen si vijon:

1. Pjesë përbërëse e këtij Ligji janë:

1.1. Marrëveshja për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, e nënshkruar në Vjenë me datën 26 gusht 2015;

1.2. Deklarata e përbashkët e Presidentit të Republikës së Kosovës, Sh.T.Z. Hashim Thaçi dhe Presidentit të Malit të Zi, Sh.T.Z. Filip Vujanović, e datës 16.2.2018.

2. Dokumentacioni zyrtar i Komisionit Shtetëror për shënimin e Kufirit Shtetëror - për orientim.

Kryetarja e komisionit propozimin e cekur më lartë e hodhi në votim, ku të pranishëm ishin 10 anëtarë të komisionit, nga të cilët 5 vota ishin për, ndërsa 5 anëtarë të tjerë nuk morën pjesë në votim.

Bazuar në rezultatin e votimit, kryetarja konstatoi që propozimi nuk kaloi dhe kërkoi që të konsultohet me zyrën ligjore, lidhur me këtë proces.

Pas konsultimit me Zyrën Ligjore, Komisioni vazhdoi punën në orën 12:00, në këtë përbërje: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjeni Thaçi-Dragusha dhe Zafir Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë nga radha e deputetëve ishin: Ali Lajçi, Sami Kurteshi dhe Fitore Pacolli-Dalipi.

Vjosa Osmani-Sadriu, theksoi se në votimin paraprak ka pasur numërim të gabuar të votave dhe se do ta përsëris votimin lidhur me propozimin për nenin 3 të Projektligjit. Ajo e lexoi përsëri tekstin e propozuar për ndryshimin e nenit 3, për të cilin tha se do të procedohet si amendament i Komisionit.

Sami Kurteshi, në lidhje me paragrafin e propozuar për dokumentacionin zyrtar, tha se ai nuk përmban as numër e as datë, se cili është ai dokumentacion.

Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare, duke u përgjigjur në çështjen e ngritur nga deputeti Kurteshi tha se dokumentacion zyrtar është i gjithë dokumentacioni që ka prodhuar Komisioni Shtetëror. Pas punës së Komisionit shtetëror, ajo tha se atij i është ndryshuar përbërja dhe Komisioni Shtetëror në përbërje të re ka vlerësuar punën e komisionit paraprak. Ajo tha se çdo material që është bërë nga Komisioni Shtetëror është përfshirë në këtë pikë. Nuk ka ndonjë datë për të përcaktuar se materiali i cilit vit është dhe të gjitha materialet shërbejnë për orientim dhe nuk kanë, karakter obligues ligjor.

Sami Kurteshi, tha se ky paragraf nuk ka ndonjë vlerë ligjore, pasi që ligji duhet të jetë i qartë dhe të ketë norma me karakter ligjor.

Vjosa Osmani- Sadriu, theksoi se paragrafi në fjalë ka karakter orientues dhe se sqarimet e mëtejme në lidhje me të do t'i rezervojë për mbledhje plenare.

Fitore Pacolli, pyeti anëtarët e komisionit, se a e dinë se raporti i Komisionit Shtetëror i kryesuar nga z. Bulliqi, konstaton shkeljet që janë bërë nga raporti i parë i Komisionit Shtetëror dhe se cili nga këto raporte do të jetë orientues.

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se i gjithë dokumentacioni zyrtar i Komisionit Shtetëror, pavarësisht kush e ka udhëhequr komisionin ka karakter orientues dhe se i takon deputetëve të vlerësojnë se cilit raport do t'i besojnë.

Time Kadrijaj, ndër të tjera tha se të gjitha këto raporte bashkë me deklaratën e përbashkët të të dy presidentëve, atij të Kosovës dhe të Malit të Zi, do të jenë pjesë e Ligjit, sepse në momentin që votohen nga deputetët, janë pjesë përbërëse të Ligjit.

Kryetarja e Komisionit e hodhi në votim propozimin për ndryshimin e nenit 3 të Projektligjit dhe pas votimit, konstatoi se komisioni nxori këtë:

P ë r f u n d i m

T'i rekomandohet Kuvendit miratimi i Projektligjit nr.06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, me amendamentin e propozuar nga Komisioni:

Amendamenti 1

Neni 3 i Projektligjit ndryshohet si vijon:

Neni 3

1. Pjesë përbërëse e këtij Ligji janë:

1.1. Marrëveshja për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, e nënshkruar në Vjenë me datën 26 gusht 2015;

1.2. Deklarata e përbashkët e Presidentit të Republikës së Kosovës, Sh.T.Z. Hashim Thaçi dhe Presidentit të Malit të Zi, Sh.T.Z. Filip Vujanović e datës 16.2.2018.

2. Dokumentacioni zyrtar i Komisionit Shtetëror për shënimin e Kufirit Shtetëror - për orientim.

Përfundimi u nxor njëzëri, nga të pranishmit në komision.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu